



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 28.1.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD),
PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA
E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.40/2012”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës në mbledhjen e datës 28 janar 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme .

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, duke bërë një rishpërndarje të fondeve.

Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr.40/2012 synon:

- rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;
- rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike.

Gjithashtu, në marrëveshje ndryshohet edhe data e mbylljes, e cila shtyhet deri më 31.12.2020.

- RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE

Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen dhe sipas propozimeve të relatorit, miratoi këto ndryshime:

1. Baza ligjore e projektligjit të ndryshojë dhe të bëhet:

“Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

2. Teksti i projektligjit të paraqitur të ndahet në dy nene, me këtë përmbajtje:

“Neni 1

Ratifikohet letërmarrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi, me ndryshimet e propozuara nga relatori, me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Edmond LEKA

KRYETARI

Ulsi MANJA